



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE

KRYESIA

Nr. 391/prot.  
5

Tiranë, më 24.10. 2019

V E N D I M

Nr. 29 .....datë 24.10.2019

Kryesia e ASH-së në mbledhjen e saj të datës 24.10.2019, me pjesëmarrjen e Kryetarit, Zëvendëskryetarit, dhe dy kryetarëve të seksioneve, në zbatim të nenit 12, pika 2, të ligjit nr.53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 33 të Statutit,

V e n d o s i:

1. Seksionet shkencore të fillojnë procedurën dhe konsultimet me anëtarët e Asamblesë, për propozimet në Kryesi për përfshirjen në listat pasive për anëtarët e “Nderit”, sipas kuptimit të nenit 13, pika 6 të Statutit të ASH.
2. Sipas nenit 7, pika 11, të Statutit çdo “Akademik i asociuar”, sipas vlerësimit të tij, me rastin e zgjedhjeve të radhës, mund të konkurojë për titullin “Akademik”, në fushën përkatëse.
3. Seksionet shkencore, anëtarët e Asamblesë, mund të bëjnë konsultime për përzgjedhjen e anëtarëve të “Jashtëm”, në zbatim të nenit 11, pika 5, të Statutit, dhe t’i paraqisin propozimet e tyre Kryesisë, në ditët në vijim.
4. Pranimin e dorëheqjes së parevokueshme të akademik Adnan Kastrati.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI